



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë- Ministarstvo Trgovine i Industrije- Ministry of Trade and Industry

Divizioni për Marrëveshje Tregtare / Departamenti i Tregtisë

Beneficionet e MSA-së në sektorin e Bujqësisë

(Rast Studimi)

Autor: Mirsad Simnica

5 Prill, 2016

Hyrje

Bujqësia luan një rol të rëndësishëm në ekonominë e Kosovës. Ajo është kontribuese kryesore në BPV-në kombëtare, që llogaritet të jetë rreth 11.9% të BPV-së për vitin 2014. Përafërsisht 60% e popullsisë në vend jetojnë në zonat rurale dhe për jetesën e tyre varen direkt ose indirekt nga sektori i bujqësisë. Bujqësia është punëdhënësi më i madh privat, duke zënë rreth një të pestën e punësimit të përgjithshëm, ndonëse kryesisht në baza joformale. Rreth 90 për qind e popullsisë ka tokë për kultivim dhe 55% ka bagëtinë e vet. Përtej konsideratave ekonomike, mbështetja e Kosovës në bujqësi ka një dimension të rëndësishëm social duke u përhapur si rrjet sigurie për një pjesë të madhe të popullsisë së saj. (Bur: ASK, MF, MTI).

Pavarësisht rritjes së qëndrueshme në sektor që nga pavarësia, bilanci i përgjithshëm i tregtisë së produkteve bujqësore është kryesisht negativ. Importet e produkteve bujqësore mbeten relativisht të larta, duke zënë rreth 10% të të gjitha importeve. Nga kjo shumë, 30% e përbëjnë ushqimi dhe produktet ushqimore. Për kokë banori, Kosova është një nga importuesit më të mëdhenj të ushqimit në Evropë. Kjo kryesisht për shkak të faktit se sektori ka mbetur kryesisht gjysmë-ekzistent për nga natyra dhe përballet me sfida të ndryshme dhe të ndërlydhura të cilat reduktojnë konkurrencën dhe parandalojnë atë të përmbush potencialin e saj të prodhimit. Si sektor i rëndësishëm i ekonomisë së Kosovës, bujqësia është e mbushur me sfida sistematike dhe strukturore që do të duhet të adresohen për të shfrytëzuar potencialet e saj konkurruese dhe të rritjes (Bur: ASK, MF, MTI). Duke u bazuar në Strategjinë e Zhvillimit Ekonomikë 2016-2021 (ZKM, Kosovë), aktualisht, bujqësia karakterizohet nga (ende) produktiviteti i dobët i përgjithshëm, kryesisht për shkak të pikave të mëposhtme:

- ndarja (fragmentimi) i tokave me mesatarisht rreth 2 hektarë (shpesh të shpërndarë mesatarisht në shtatë parcela më të vogla, duke rënduar më tej ekonominë e shkallës);
- teknologjia e vjetërsuar bujqësore dhe mungesa e njohurive/aftësive moderne bujqësore në mesin e fermerëve dhe agro-përpunuesve;
- mungesa e diversifikimit të produkteve bujqësore;
- Mungesa e investimeve në sisteme të ujitjes dhe mungesa e një sistemi të menaxhimit të ujitjes me pjesëmarrje;

- qasje të kufizuar dhe kosto veçanërisht të larta të kredive dhe kapitalit investues, pjesërisht pasqyrojnë informalitetin e lartë dhe paaftësinë për të realizuar vlerën e kolateralit (p.sh., për shkak të dobësive në të drejtat e pronësisë në lidhje me disponueshmërinë dhe besueshmërinë e dokumenteve të pronarit të tokës dhe hartat);
- objekte me përpunim të kufizuar, përfshirë mungesën e magazinimit, paketimit, dhe objekte të transportit;
- Zbatimi i kufizuar i standardeve të sigurisë ushqimore dhe higjienike;

Masat e Domosdoshme

Një masë e domosdoshme dhe urgjente për ti adresuar këto sfida është që të sigurohet se rritjet e planifikuara në subvencione bujqësore të drejtohen ekskluzivisht në nismat për rritje të produktivitetit. Gjithashtu Kosova duke u bazuar në Strategjinë për Bujqësi 2020 të BE-së ka planifikuar një sërë objektivash për zhvillimin e bujqësisë si: prodhimin e ushqimit të shëndetshëm, menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe veprimeve klimatike dhe zhvillimin e balancuar territorial të zonave rurale. Skemat mbështetëse do të kontribuojnë drejtpërdrejt në:

- **Rritjen e produktivitetit** - përmes zbatimit të masave sipas Programit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Qeveria synon të kontribuojë në rritjen e produktivitetit, rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit, përdorimin e teknologjive të reja dhe zëvendësimin e atyre të vjetra. Rritjen e cilësisë dhe standardeve të sigurisë nëpërmjet investimeve në agro-përpunim pas hyrjes në fuqi të MSA-së.
- **Rriorientimin e politikave ekzistuese** - përmes promovimit të kulturave të reja me prioritet dhe përparësi konkurruese dhe bujqësisë organike;
- **Aktivitetet e diversifikimit** - Zhvillimi i turizmit rural dhe aktivitet tjera, përveç mbledhjes dhe kultivimit të bimëve mjekësore dhe aromatike, dhe produkteve pyjore jodrusore dhe plasimit të tyre në tregjet e BE-së.
- **Transferimi i inovacionit dhe njohurive** në bujqësi, pylltari dhe zonat rurale dhe forcimi i kapaciteteve të administratës publike në zbatimin e programeve të zhvillimit rural;

Ndarja buxhetore për masat e shtyllës së parë për vitin 2016 është 50%, nga buxheti total për grante dhe subvencione. Zbatimi i këtyre masave është në përputhje me Politikën e Përbashkët Bujqësore, pasi në kuadër të BE-së, alokimi i buxhetit për pagesat e drejtpërdrejta është i ndarë në 73% për pagesave direkte dhe 27% për aktivitete tjera. Zbatimi i këtyre aktiviteteve të

parapara për programin e reformave ekonomike të vitit 2016 do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e prodhimit bujqësor dhe përpunimin, krijimin e vendeve të reja të punës dhe mbështetjen e atyre ekzistuese. Gjithashtu, kjo masë do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e jetesës në zonat rurale, me anë të zbatimit të projekteve rurale të diversifikimit dhe përfshirjen e grupeve lokale të veprimit. Në përgjithësi, zbatimi i këtyre masave do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik të vendit me hyrjen në fuqi të MSA-së.

Marrëveshja për Stabilizim Asocim (MSA) në mes të BE-së dhe Kosovës, e cila është nënshkruar në vitin e kaluar dhe miratuar tani nga Parlamenti Evropian (PE), pritet të hyjë në fuqi në qershor të këtij viti.

Nga marrëveshja del se tarifat doganore, në fazën e parë, do të hiqen plotësisht për gjithsej 2 mijë e 564 produkte bujqësore të përpunuara, përveç mishit, verës dhe produkteve të sheqerit. Ndërsa për produktet industriale, përkatësisht veturat dhe makineritë, tarifat doganore janë të përshkallëzuara për shtatë vitet e ardhshme, dhe ato do të lirohen nga tarifa doganore me zero për qind vetëm pas kësaj periudhe kohore.

MSA prodhon dy lloj efektesh materiale dhe procedurale. Tek efektet materiale është tatimi doganor, i cili për një pjesë të mallit do të eliminohet në tërësi, për ato mallra të cilat nuk janë të parapara në anekse, për arsye se në Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit janë nëntë anekse dhe pesë protokolle.

Marrëveshja e MSA-së është e ndarë në tre kapituj: Kapitulli industrial (ku përfshihen edhe veturat dhe makineritë), produktet bujqësore dhe peshkataria si një lëmi e veçantë.

Kjo marrëveshje mundëson që produktet e Bashkimit Evropian të hyjnë në Kosovë me taks zero për qind ose me taksë të përshkallëzuar, e cila vjen duke rënë me kalimin e viteve, por normalisht e favorizon edhe ekonominë kosovare, sepse i mundëson edhe prodhuesve të Kosovës që të eksportojnë një treg shumë më të gjerë në Bashkimin Evropian.

Produktet bujqësore, kanë një shkallë progresive të zbritjes së tatimit doganor. Ky është ai efekti material në të cilin ka ndikim MSA-ja. Në vitin e parë, sipas kalkulimeve, parashihet të ketë një zvogëlim në të hyra të tatimit doganor për 24 milionë euro. (Bur: MF, DK).

Disa nga produktet bujqësore si patatja dhe produktet e qumështit hyjnë në mesin e produkteve bujqësore për të cilat BE heq tarifat doganore nga hyrja në fuqi e MSA. Kurse për produktet e

mishit të viçit BE-ja do të fiksoj tarifën doganore të aplikueshme për eksport nga Kosova në BE në 20 për qind tarifë.

Janë 14 produkte bujqësore më të rëndësishme që ne kemi kapacitet të mjaftueshëm për ti prodhuar e ato janë: qumështi, patatja, vera edhe disa produkte të tjera. Këto në momentin që MSA hyn në fuqi përveç verës do të kenë eksport doganor 0 për qind në tregun e BE. Ndërsa, njëkohësisht do të vlejë importi tarifar doganor 10 për qind në importin e këtyre produkteve çdo herë. Të gjitha këto produkte janë të mbrojtura nga importi, sepse nuk janë negociuar fare, ndërsa sa i përket eksportit BE-ja i ul tarifat doganore në zero për qind për produktet bujqësore përveç produkteve të mishit dhe verës në momentin që MSA hyn në fuqi.

Kjo marrëveshje është një hap shumë i rëndësishëm në aspektet ekonomike dhe tregtare. Kjo marrëveshje është asimetrike që do të thotë se të gjitha prodhimet vendore do të kenë qasje të plotë në tregun e BE-së përveç atyre që janë të negociuara përmes kuotës. Por edhe kjo përmes kuotës është në favor të produkteve tona.

Qasja e prodhimeve të Bashkimit Evropian do të liberalizohet në formë të periudhës tranzicionale, 5 vjeçare, 7 vjeçare deri në 10 vjeçare. Parimisht Kosova ka negociuar produktet në këtë formë: të gjitha ato produkte të cilat Kosova aktualisht ka potencial, i prodhon dhe do të kenë potencial afatmesëm për ti prodhuar në një formë janë mbrojtur nga importi i BE-së në periudha 5 vjeçare, 7 vjeçare dhe 10 vjeçare.

Produktet bujqësore - importet

- i) Kosova, që nga hyrja në fuqi e MSA-së, do të shfuqizojnë tarifat doganore për 1,044 nga 2,564 produkte bujqësore nga BE-ja. Ndërsa 164 produkte bujqësore të BE-së tashmë janë të liruara nga tarifa doganore me Ligjin Nr. 04/L-163 për Mallrat e Liruara nga Tatimi Doganor dhe Mallrat me Tarifë Zero të Tatimit Doganor.
- ii) 256 produkte senzitive bujqësore (180 bujqësore dhe 76 të procesuara bujqësore) të rëndësishme për fermerët e Kosovës do të mbrohen për 7 vjet (*lëngje frutash si lëng molle, mango, luleshtrydhe, kumbulla etj, xhem dhe marmelatë, patate, miell, mish dhe mish i shpezëve si dhe djathë*).

- iii) Tarifa doganore e Kosovës do të reduktohet gradualisht për një periudhë **5-vjeçare** për import të **kafes** dhe produkteve të saj (**për llojin e pa pjekur dhe pa kafeinë**) nga BE dhe **për 7 vite për llojet e kafes me kafeinë** (të pjekur dhe pa pjekur).
- iv) 14 produkte kanë qenë të pa-negociueshme dhe nuk janë përfshirë në marrëveshje, gjë që do të thotë se tarifa Kosovare do të mbetet e njëjtë (10%) për ato produkte (që kryesisht përfshijnë produkte të *qumështit dhe krem, kos, patate, molle, verë*).

Patatja (e papërpunuar), **qumështi** (me disa produkte të qumështit si kremi dhe jogurti që nuk përmbajnë sheqer ose fruta të shtuar), dhe **vera e rrushit** nuk janë përfshirë fare në marrëveshje për shkak të rëndësisë që kanë për prodhuesit vendor. Pra, tarifa doganore prej 10% mbetet në fuqi për këto produkte. (Për lloje tjera dhe nën-produkte të këtyre produkteve, tarifat do të hiqen gradualisht brenda 5 dhe 7 viteve).

- v) 12 produkte shumë të rëndësishme për prodhimin bujqësor të Kosovës (8 bujqësore dhe 4 të përpunuara bujqësore) do të mbrohen për 10 vjet (*produkte të qumështit, fruta dhe perime, ujë, birrë dhe produkteve të grurit*).
- vi) Kosova do të shfuqizojë tarifën doganore për 487 produkte të peshkut me hyrjen në fuqi të marrëveshjes. Për 1 produkt të peshkut tarifa doganore e Kosovës do të hiqet gradualisht për 5 vite (makarel), për një produkt peshku (produkte të caktuara **trofte**) **tarifa hiqet gradualisht për 7 vite**

Eksporti në BE

- vii) Tarifat doganore do të hiqen plotësisht (nga hyrja në fuqi) **për produkte bujqësore** (gjithsej janë 2,564 produkte bujqësore, te përpunuara bujqësore dhe produkte peshku), **përveç mishit, verës dhe produkteve të sheqerit**.
- viii) BE heq tarifat doganore nga hyrja në fuqi e marrëveshjes **për të gjitha produktet e mishit** (të freskët dhe të ngrirë) përveç për mishin e viçit ("baby beef"). Për produktet e kafshëve të kapitujve 7 dhe 8 të Nomenklaturës së Kombinuar (produkte të

ndryshme të lëkurës), ku aplikohet tarifa doganore ‘ad valorem’ (20%) dhe tarifa doganore specifike (20%), elimini përfshin vetëm tarifën ‘ad valorem’.

- ix) Për produktet e **mishit të viçit** (baby beef), BE do të fiksojë tarifën doganore të aplikueshme për eksport nga Kosova në BE në 20% tarifë ‘ad valorem’ dhe 20% tarifë specifike (tarifa preferenciale) brenda limitit të kuotës vjetore prej 475 tonë (shprehur në peshë trupore)
- x) BE heq tarifatat doganore për llojet e **kafes** me kafeinë nga hyrja në fuqi e marrëveshjes
- xi) **Patatja dhe qumështi** hyjnë në mesin e produkteve bujqësore për të cilat BE heq tarifatat doganore nga hyrja në fuqi e MSA.
- xii) Eksporti në BE i **verës së rrushit** të freskët dhe ‘**sparkling wine**’ koncesionohet/lirohet nga tarifa doganore deri në limitin e caktuar me kuota. për verën e rrushit kuota është 40,000 hektolitër, dhe për ‘sparkling wine’ kuota është 10,000 hektolitër.¹
- xiii) **Trofta dhe Krap:** Aplikohet kuota. Tarifa doganore në BE nuk vlen deri në volumnin prej 15 tonë për vit për troftë. Kuota për krap është 20 tonë në vit. Pas kësaj sasi, aplikohet tarifa doganore e BE.

Reduktimi Gradual nënkupton:

Reduktimi gradual për 5 vite

Hyrja ne fuqi Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5
80 % e tarifës bazë	60 %	40 %	20 %	Tarifa hiqet

¹ Importi realizohet me kusht qe te prezantohet certifikata dhe një dokumenti shoqërues te cilat lëshohen nga një trup zyrtar I njohur bilateralisht qe do te vendoset ne listën qe hartohet bashkërisht nga palët.

Reduktimi gradual i tarifës për 7 vite

Hyrja ne fuqi Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7
90 % e tarifës baze	80 %	70 %	50 %	30 %	10 %	Tarifa hiqet

Reduktimi gradual i tarifës për 10 vite

Hyrja ne fuqi Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
100 % e tarifës baze	100 % e tarifë s baze	90 % e tarifë s baze	80 %	70 %	60 %	50 %	30 %	10 %	Tarif a hiqet

Shënim: 90% e tarifës bazë domethënë e tarifës doganore te Kosovës te datës 31 Dhjetor te viti 2013. Kjo tarifë në këtë datë ishte 10%. Pra kur thuhet reduktohet ne 90%, d.m.th bëhet 9% e kështu me radhë.